



BANKA POPULLORE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

**PROGRAMI I PUNËS
SË BANKËS POPULLORE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR VITIN 2017**

dhjetor 2016

Në bazë të nenit 47 paragrafi 1 pika 9 nga Ligji i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 158/10, 123/12, 43/14, 153/15 dhe 6/16) dhe neni 54 paragrafi 1 alineja 3 nga Rregullat për planifikim strategjik dhe operacional Rr. Nr..02-15/I-1/2016 nga 28 janar 2016, Këshilli i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë miratoi

Programin e punës në Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë për vitin 2017

1. Qëllimi kryesor i Programit të punës së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) është të sigurojë orientim optimal të burimeve të disponueshme kah lëmitë prioritare, forcimi i kapaciteteve në të gjitha segmentet e punës, si dhe ndjekja dhe vlerësimi i rezultateve të efikasitetit të masave të ndërmarra dhe aktiviteteve.

2. Programi i punës përfshin aktivitete të programit për realizimin e qëllimeve strategjike në pajtueshmëri me Planin Strategjik të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2017-2019, P.L. nr. 02-15/VII-1/2016 prej 26 maj 2016.

3. Aktivitetet e programit përmbajnë një ose më shumë procese punuese funksionalisht të ndërlidhura dhe projekte për realizimin e të cilëve përgjigjet një ose më shumë njësi organizative të cilat kanë një qëllim të përbashkët, kompetenca saktësisht të përcaktuara, afate dhe burime.

4. Aktivitetet e programit janë nga lëmia e politikës monetare, mbikëqyrjes, rregulbret bankare dhe stabiliteti financiar, tregjet financiare, menaxhimi me rezervat valutore, zhvillim i veprimtarisë hulumtuese, emetimi dhe menaxhimi me kartëmonedhat dhe monedhat, sistemet e pagesave, statistikës, si dhe një numër i madh i aktiviteteve që paraqesin përkrahje të funksioneve themelore të Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë (në tekstin e mëtejshëm: Banka Popullore) të lidhura me financat dhe kontabilitetin, teknologjinë informative dhe menaxhimin korporativ.

Programi i punës përmban edhe aktivitete të orientuara kah harmonizimi i nevojave juridike, organizative dhe të resurseve të Bankës Popullore në procesin e aderimit kah Banka Qendrore Evropiane dhe Sistemit Evropian të Bankave Qendrore, që është në pajtueshmëri me rekomandimet që dalin nga raporti "Analiza e nevojave të Bankës Popullore", i miratuar nga Këshilli Drejtues i IPA projektit.

Në vitin 2017 shënohen 25 vite nga pavarësia monetare e Republikës së Maqedonisë. Ky vit jubilar do të shënohet me disa ngjarje jubilarë në organizim të Bankës Popullore.

5. Programi i punës përmban 129 aktivitete të programit, prej të cilave 106 janë të procese të rregullta punuese, të cilat realizohen gjatë vitit dhe përmes të cilave drejtpërdrejt sigurohet realizimi i qëllimeve strategjike të Bankës Popullore.

Programi i punës përmban edhe 23 projekte të cilat mundësojnë futjen e ndryshimeve në punë për sa i përket rritjes së efikasitetit, kualitetit, transparencës dhe sigurisë, harmonizimin me kërkesat e reja ligjore, rregullat evropiane, standardet ndërkombëtare dhe me kërkesat e FMN-së.

6. Shpërndarja e aktiviteteve të programit sipas qëllimeve të përcaktuara strategjike dhe bartësit është e bërë si vijon:

Qëllimi strategjik 1 – Ruajtja e stabilitetit të çmimeve përmes kursit stabil të denarit në raport me euron.

Fusha: Politika monetare

Aktivitete të programit:

- ≠ Përgatitja e projeksioneve makroekonomike.
- ≠ Përgatitja e analizave për menaxhimin e borxhit publik dhe të jashtëm, kurs valutor të balancuar dhe transmetim monetar të cilat përdoren gjatë marrjes së vendimeve të politikës monetare.
- ≠ Sondazhe.
- ≠ Përgatitje e ad hoc analizave.
- ≠ Përpunimi i raporteve të rregullta.
- ≠ Implementimi i rregullt i operacioneve monetare dhe ruajtja e ekuilibrit në tregun e valutave të huaja.
- ≠ Promovim aktiv i kursimit në denarë.

Bartës: Drejtoria për PMK dhe TF

Qëllimi strategjik 2 – ruajtja e sistemit stabil dhe të sigurt bankar si një parakusht për stabilitet financiar dhe rritje të qëndrueshme ekonomike të vendit.

Fusha: Mbikëqyrje, rregullativa bankare dhe stabiliteti financiar

Aktivitetet e programit:

- ≠ Përpunimi dhe miratimi i rregullativës në sferën e veprimtarisë bankare dhe mbikëqyrjes bankare.
- ≠ Analiza dhe ndjekje të zhvillimeve në sistemin bankar dhe financiar.
- ≠ Aktivitete të rregullta të mbikëqyrjes nga jashtë (off-site).
- ≠ Rishikimi i metodologjisë së brendshme për vlerësimin e rreziqeve të veçanta dhe profilin e përmbledhur të rreziqeve të bankave.
- ≠ Rishikimi i përmbajtjes së raporteve të përcjelljes nga jashtë (off-site) të bankave (profili i rrezikut dhe analiza financiare).
- ≠ Rishikimi i nevojës së harmonizimit të procedurave për vlerësim në vend dhe nga jashtë të rreziqeve.
- ≠ Zhvillim i mëtejshëm i metodologjisë së brendshme për vlerësim të procesit për identifikim të kapitalit (PIK) të bankave dhe përcaktimi i shtesave/nevojave kapitale për bankat e veçanta nga ana e Bankës Popullore.
- ≠ Zbatimi i kontroleve të rregullta në teren.
- ≠ Rishikimi i procedurave për vlerësim të rreziqeve individuale.
- ≠ Rishikimi i standardeve të ekzistuese të vazhdimësisë së punës.
- ≠ Forcimi i kapacitetit të mbikëqyrësve në pjesën e mbikëqyrjes së sistemeve të pagesave.
- ≠ Bashkëpunim me institucionet ndërkombëtarë për forcimin e kapaciteteve për parandalimin e larjes së parave.

Bartës: Drejtoritë për FB, MJL dhe MT

Qëllimi strategjik 3 – Menaxhim efikas me rezervat valutore të Republikës së Maqedonisë me balancim optimal ndërmjet principeve të sigurisë, likuiditetit dhe (rezultatit) nga menaxhimi.

Fusha: Menaxhim me rezervat valutore.

Aktivitetet e programit:

- ≠ Menaxhim me rreziqet.
- ≠ Ndjekje dhe analizë efikase të pozicioneve investuese.
- ≠ Menaxhim me rezervat valutore të Republikës së Maqedonisë.

Bartës: Drejtoritë për TF

Qëllimi strategjik 4 – mbështetje të zhvillimit të tregjeve financiare në vend.

Fusha: Tregjet financiare në vend.

Aktivitetet e programit:

≠ Pjesëmarrje dhe mbështetje të zhvillimit të tregjeve financiare të vendit.

Bartës: Drejtoritë për TF

Qëllimi strategjik 5 – Rritja e efikasitetit të sistemit për furnizim dhe përpunim të kartëmonedhave dhe monedhave përmes rritjes së kualitetit dhe funksionalitetit të parave të gatshme në qarkullim.

Fusha: Emetim dhe menaxhim me kartëmonedhat dhe monedhat.

Aktivitetet e programit:

- ≠ Furnizim i bankave dhe qendrave për para të gatshme me kartëmonedha dhe monedha.
- ≠ Kontroll për aplikimin e standardeve dhe kritereve për punë me para të gatshme te bankat dhe qendrat për para të gatshme.
- ≠ Përpunimi/blerja e kartëmonedhave dhe monedhave, kambialeve, monedha jubilarë dhe monedha për qëllime koleksionuese.
- ≠ Vendosja e një koncepti të ri bashkëkohorë për menaxhim dhe trajtim të parave të gatshme.
- ≠ Aktivitete për nevojat e Bankës Popullore, institucioneve shtetërore dhe autoritetet drejtuese.

Bartës: Drejtoria TR

Qëllimi strategjik 6 – ruajtja e nivelit më të lartë të sigurisë, stabilitetit dhe efikasitetit të sistemeve të pagesave në vend dhe sigurimi i kushteve për lidhje ndërkufitare të sistemeve të pagesave.

Fusha: Sistemet e pagesave.

Aktivitetet e programit:

- ≠ Avancimi i punës së MIPS për pagesa ndërkufitare në euro nëpërmjet TARGET2.
- ≠ Aplikimi i rregullativës së re me anë të së cilës transponohen direktivat e BE-së në fushën e shërbimeve pagesore në pajtueshmëri me IPA projektin e implementuar nga viti 2015-16.
- ≠ Analizë e Direktivës për llogaritë për pagesë të BE-së.
- ≠ Operacione pagesore jashtë vendit në llogari të shtetit ose autoriteteve shtetërore.
- ≠ Përpunimi dhe balancimi i transaksioneve të ndërlidhura me menaxhimin e rezervave valutore dhe implementimin e politikës monetare, ndjekje dhe mbështetje e balancimit të transaksioneve të tregjeve përmes sporteleve.
- ≠ Mbikëqyrje të sistemeve për pagesë.

- ≠ Mbështetje për pjesëmarrësit në MIPS dhe përpunimi i urdhëresës për pagesë të detyruar.
- ≠ Organizimi i Konferencës së Dhjetë për sistemet e pagesave dhe sistemet për rregullime të letrave me vlerë.

Bartës: Drejtoria për SP

Qëllimi strategjik 7 – Zhvillim i veprimitarisë hulomtuese në fushat të cilat janë kyçe për realizimin efikas të qëllimeve të Bankës Popullore.

Fusha: Veprimtari hulomtuese.

Aktivitetet e programit:

- ≠ Përgatitja e materialeve punuese dhe aktivitete të tjera nga fusha e veprimitarisë hulomtuese.
- ≠ Organizimi i Konferencës vjetore të Bankës Popullore

Bartës: Ekonomisti kryesor, drejtoritë për PMK dhe FB

Qëllimi strategjik 8 – sigurimi i të dhënave kualitative statistikore, plotësisht të harmonizuara me standardet statistikore ndërkombëtare dhe evropiane, duke pasur parasysh rëndësinë raportuese dhe diseminimin e saj efikas, të thjeshtë dhe në kohë deri te përdoruesit.

Fusha: Statistikë

Aktivitetet e programit:

- ≠ Përpunim dhe shfaqja e të dhënave për këmbim të jashtëm tregtar për përdorim të brendshëm, përgatitje dhe publikim të raporteve të kursit të këmbimit dhe kursit real efektiv të këmbimit.
- ≠ Raporte për bilancin e pagesave, për rezervat zyrtare valutore dhe likuiditetin valutor.
- ≠ Raporte për investime direkte.
- ≠ Raporte për borxhin e jashtëm, llogaritë e arkëtueshme nga jashtë dhe neto borxhin e jashtëm.
- ≠ Raporte për pozicionin e investimeve ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë.
- ≠ Vendosja e një sistemi për menaxhim, pritje, përpunim dhe trajtim me të dhënat statistikore, vendosja e një depoje të dhënash.
- ≠ Dorëzimi i të dhënave për treguesit makroekonomik të Republikës së Maqedonisë deri te BIS.
- ≠ Dorëzimi i të dhënave për Faqen Kombëtare për të dhëna statistikore në FMN.
- ≠ Aktivitete për sektorizim të unifikuar të njësive institucionale në nivel kombëtar.
- ≠ Statistikë për letra me vlerë.

- ≠ Vendosja e statistikës së llogarive financiare të transaksioneve dhe bilanceve, në pajtueshmëri me SNA 2008 DHE ESA 2010.
- ≠ Përpunimi i pasqyrave monetare.
- ≠ Projekt për vendosjen e një sistemi të integruar për raportimin e të dhënave nga ana e Bankës Popullore, bankat, kursimoret, për qëllime statistikore dhe mbikëqyrëse.
- ≠ Raporte për normat e ponderuara të interesit në bankat dhe kursimoret për depozitat e pranura dhe kreditë të miratuara.
- ≠ Raporte për gjendjen e mjeteve dhe detyrimet e institucioneve financiare.
- ≠ Pranim dhe përpunim i të dhënave për investimet e jashtme direkte në Republikën e Maqedonisë dhe jashtë.
- ≠ Pranim dhe përpunim i të dhënave për pretendime afatshkurtra dhe detyrimeve të veprimtarisë komerciale me jo rezidentët.
- ≠ Pranim dhe përpunim i të dhënave për rezultatin financiar të subjekteve të lidhura në bazë të investimeve jashtë vendit.
- ≠ Llogaritje e zhvillimeve të investimeve të jashtme dhe portfolio-investimeve në Republikën e Maqedonisë.
- ≠ Pranim dhe përpunim i të dhënave për borxhin e jashtëm dhe llogarive të arkëtueshme nga jashtë.
- ≠ Evidencë e punëve kreditore jashtë vendit.
- ≠ Pranim dhe përpunim i të dhënave të operacioneve pagesore në fushën e bankave me vendet e jashtme.
- ≠ Pranim dhe përpunim i të dhënave të raporteve mujore për transaksionet me vendet e jashtme.
- ≠ Mjet për analizë të të dhënave statistikore dhe internet portal statistikor për përdoruesit e jashtëm të të dhënave.
- ≠ Qasje deri te SDDS (SSDDH – Standardi special për desiminimin e të dhënave) plus standardin për desiminim të të dhënave të FMN-së.
- ≠ Përpilimin e Programit për kërkime statistikore për periudhën 2018-2022.
- ≠ Përgatitja raportesh nga të dhënat e dorëzuara për operacionet e pagesave në vend.

Bartës: Drejtoritë për ST dhe SP

Qëllimi strategjik 9 – përgatitje e Bankës Popullore për kyçje dhe anëtarësim në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore.

Fusha : Përgatitje për hyrje të Bankës Popullore në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore.

Aktivitetet e programit:

- ≠ Menaxhim me projektet e financuara nga Instrumenti i asistencës para anëtarësimit – IPA.

- ≠ Aktivitete të lidhura me procesin e hyrjes së Bankës Popullore në Sistemin Evropian të Bankave Qendrore.
- ≠ Koordinimi i projekteve të lidhura me bashkëpunim teknik të Bankës Popullore dhe bankat tjera qendrore si dhe institucionet ndërkombëtare.

Bartës: KG dhe më shumë NJO në Bankën Popullore

Qëllimi strategjik 10 – Ndjekje e trendëve në veprimtarinë e bankave qendrore, forcimi i fleksibilitetit për sa u përket ndryshimeve që i imponon mjedisi, menaxhim efektiv me rreziqet në të gjitha segmentet e punës, sigurimi i vazhdimësisë së punës dhe sigurimin e sistemit informativ, përmirësimin e transparencës dhe përgjegjësisë shoqërore të institucionit.

Fusha: Financa, kontabilitet dhe kontroll.

Aktivitetet e programit:

- ≠ Regjistrimi i transaksioneve valutore.
- ≠ Regjistrimi i transaksioneve me kartëmonedha dhe monedha, si dhe vlera tjera.
- ≠ Regjistrimi i instrumenteve monetare dhe depozitave në denarë.
- ≠ Likuidimi i dokumenteve kontabël për blerje të kryera të mallrave, shërbimeve dhe punëve dhe detyrimeve për pagesë në baza të tjera, regjistrimi dhe pagesa e pretendimeve (fatura dalëse) dhe llogaritja e detyrimeve për TVSH.
- ≠ Operacione të arkëtarisë, pagesa në bazë të Kontratës Kolektive dhe llogaritja e tatimit personal.
- ≠ Llogaritja dhe regjistrimi i pagës, kontributet dhe kompensimet për pagën.
- ≠ Raportim financiar.
- ≠ Planifikim.
- ≠ Sistem i integruar kontabël.

Fusha: Auditim i brendshëm.

Aktivitetet e programit:

- ≠ Planifikimi dhe përpunimi i Programeve vjetore dhe trevjetore për punë të Auditimit.
- ≠ Kryerja e auditimit.
- ≠ Vlerësim i jashtëm për punën e Drejtorisë për Auditim të Brendshëm (DAB) nga Banka Qendrore e Holandës.

Fusha: Planifikimstrategjik, menaxhimi me rreziqet, sigurimi i vazhdueshmërisë së punës dhe sigurisë së sistemit informativ dhe mbrojtja e të dhënave personale.

Aktivitete të programit:

- ≠ Aktivitete për të siguruar vazhdueshmëri të punës në Bankën Popullore.
- ≠ Kontroll për pajtueshmëri me rregullat për mbrojtje të të dhënave personale në Bankën Popullore.
- ≠ Ndjekja dhe regjistrimi i incidenteve.
- ≠ Kontroll periodik për pajtueshmëri të punës me rregullat për mbrojtje të të dhënave personale dhe rregullativës së brendshme për siguri të sistemit informativ.
- ≠ Planifikim strategjik.
- ≠ Menaxhim me rreziqet operative në nivel të Bankës Popullore.

Fusha: çështjet juridike

Aktivitetet e programit :

- ≠ Kontroll për pajtueshmëri të punës me rregullat.
- ≠ Përgatitja dhe kontrolli i ligjeve, akteve të përgjithshme dhe të veçanta juridike, si dhe azhurnimi i regjistrimit të rregullave të Bankës Popullore.
- ≠ Përgatitje të Mbledhjeve të Këshillit të Bankës Popullore.
- ≠ Përgatitje e dokumenteve juridike, padive, përgjigje ndaj padive dhe mjete juridike të jashtëzakonshme.
- ≠ Dhënia e opinioneve juridike, këshillave dhe trajnime.

Fusha: Marrëdhënie ndërkombëtare.

Aktivitetet e programit:

- ≠ Ndjekje dhe koordinim të detyrave të cilat dalin nga anëtarësimi i Bankës Popullore në institucionet ndërkombëtare financiare.

Fusha: Marrëdhënie me publikun.

Aktivitetet e programit:

- ≠ Komunikimi me publikun.
- ≠ Zhvillim i funksionit edukativ të Bankës Popullore në drejtim të ngritjes së nivelit të edukimit financiar të publiku.
- ≠ Organizim, koordinim dhe kryerja e punëve të protokollit në Bankën Popullore.
- ≠ Organizimi i udhëtimeve zyrtare.

Fusha: Aktivitete botuese.

Aktivitetet e programit:

- ≠ Avancimi i faqes së brendshme dhe faqes zyrtare të internetit të Bankës Popullore.
- ≠ Emetimi i monedhave për qëllime koleksionuese.

Fusha: Menaxhimi me burimet njerëzore.

Aktivitetet e programit:

- ≠ Trajnim profesional dhe zhvillim i të punësuarve.
- ≠ Vendosja e pozicionimit të duhur organizacional dhe sistematik.
- ≠ Sigurimi i angazhimit të të punësuarve.
- ≠ Përbushja e të drejtave dhe detyrave nga marrëdhënia e punës.
- ≠ Web-faqja e brendshme dhe promovimi i aktiviteteve të të punësuarve.

Fusha: Teknologjia informatike.

Aktivitetet e programit:

- ≠ Kryerja e ndryshimeve në sistemin e TI-së.
- ≠ Menaxhim me sigurië përmes harmonizimit të standardeve ndërkombëtare dhe rregullativës së brendshme dhe kontroll të aktiviteteve të të punësuarve.
- ≠ Përpunim dhe përditësim të aplikacioneve.
- ≠ Aktivitete të rregullta nga fusha e TI-së.
- ≠ Sigurimi i vazhdueshmërisë së punës.
- ≠ Mirëmbajtja e infrastrukturës së TI-së.
- ≠ Dhënia e shërbimeve të TI-së.
- ≠ Mirëmbajtja e aplikacioneve.

Fusha: Prokurime publike.

Aktivitetet e programit:

- ≠ Përgatitje dhe zbatim të procedurave për prokurime publike.
- ≠ Ndjekje e kontratave në bazë të prokurimeve publike dhe pranim, regjistrim dhe kontroll të faturave dhe dokumenteve tjera kontabël.
- ≠ Pjesëmarrje në zbatimin e projektit për ndërtimin e objektit të ri të Bankës Popullore.

Fusha: Mirëmbajtje teknike, siguri dhe arkiv.

Aktivitetet e programit:

- ≠ Puna në zyrë.
- ≠ Puna arkivore.
- ≠ Sigurim fizik dhe mbrojtje nga zjarri.
- ≠ Mirëmbajtje e objekteve.
- ≠ Sigurimi i shërbimeve transportuese.
- ≠ Zhvillimi i DMS (sistemit për menaxhim me dokumentet).

Fusha: Muze.

Aktivitetet e programit:

- ≠ Blerja e materialit numizmatik.

- ≠ Përpunimi i dokumentacionit të muzeut.
- ≠ Konservimi i materialit numizmatik dhe aktivitete tjera të Laboratorit të Konservimit.
- ≠ Trajtim fizik me objektet nga Koleksioni numizmatik, ruajtja e tyre e sigurt, qasje deri te hapësirat e punës dhe mbrojtje gjatë punës në Laboratorin e konservimit.
- ≠ Edukim i muzeut/muzeor dhe masa për siguri gjatë vizitës së materialit të muzeut të Bankës Popullore.
- ≠ Organizimi i një ekspozite mysafirësh në Lubjanë.

Fusha: Biblioteka dhe arkivi.

Aktivitetet e programit:

- ≠ Blerje dhe mirëmbajtje të fondit të bibliotekës së Bankës Popullore.
- ≠ Informimi i të punësuarve të Bankës Popullore përmes faqes së brendshme.
- ≠ Digjitalizim i materialit arkivor me rëndësi historike që rrjedh nga Banka Popullore.

Bartës: FKK, IT, PJ, PP, KG, MTSA, BNJ, Muzeu, BA, AB dhe këshilltarët e guvernatorit.

7. Programi i punës parasheh një pjesë të proceseve punuese dhe projekteve të realizohen në bashkëpunim me njësi tjera organizative – dhënës shërbimesh, që i referohet realizimit të projekteve në fushën e teknologjisë së informacionit, bashkëpunim gjatë realizimit të projekteve të lidhura me IPA dhe organizimin e ngjarjeve të lidhura me punën në Bankën Popullore.

8. Projektet e fushës së teknologjisë së informacionit janë të ndara nëpër njësi organizative dhe janë të prezantuara në shtojcën 1 të këtij programi të punës.

9. Gjatë vitit 2017 do të organizohen dy ngjarje për hirë të mbajtjes së Konferencës vjetore të Bankës Popullore dhe Konferencës së Dhjetë të sistemeve të pagesave për rregullime të letrave me vlerë. Bartës të këtyre projekteve do të jenë KG dhe DSP, në bashkëpunim me DPR dhe MTSA.

10. Programi për punë përmban aktivitete për testim të planit për sigurim të vazhdueshmërisë së punës në 23 procese punuese, me çka është lejuar vlerësim i mirëmbajtjes së planeve dhe shqyrtimit të problemeve të mundshme si dhe pengesave gjatë implementimit të tyre.

11. Pjesë përbërëse e këtij programi të punës është projektimi i rishikuar i bilancit të gjendjes aktuale dhe për tre vitet e ardhshme, i cili i përmban pasojat financiare nga realizimi i tij, të prezantuara në shtojcën 2.

12. Programi i punës realizohet gjatë një viti kalendarik, duke filluar nga 1 janar deri në 31 dhjetor 2017.

13. Programi i punës hyn në fuqi nga dita e miratimit të tij.

Pr. nr.02-15/XIV-1/2016
15 dhjetor 2016
Shkup

Guvernator
dhe Kryetar i Këshillit
të Bankës Popullore të
Republikës së Maqedonisë
Dimitar Bogov

Shtojca 1

Projekte nga fusha e teknologjisë informative

NjO	Titulli i IT-projektit
ST	<p>ST1 Automatizimi i një pjese të tabelave të brendshme analitike për këmbim të jashtëm tregtar.</p> <p>ST2 Automatizimi i një pjese të raporteve për Bankën Botërore.</p> <p>ST4 Përditësimi i softuerit aplikativ për punë komerciale me jo rezidentët.</p> <p>ST5 Përditësimi i softuerit aplikativ për evidencë të punëve kreditore me vendet e jashtme.</p> <p>ST8 Krijimi i një baze të vetme të të dhënave statistikore.</p> <p>ST10 Automatizimi i kompletit monetarë të rishikuar rregullisht në bazë të standardeve të reja statistikore të FMN-së.</p> <p>ST11 Harmonizimi i mëtejshëm i statistikës së normave të interesit me kërkesat e BE dhe FMN-së.</p> <p>ST13 Vendosja e burimeve të reja në suaza të statistikës së letrave me vlerë.</p> <p>ST14 Përgatitje për bashkimin e Republikës së Maqedonisë në standardin e FMN-së për SDDS(SSDDH - Standardi special për desiminimin e të dhënave) plus.</p> <p>ST15 Aktivitete për implementimin e projektit ISIDORA (përgatitje për kompletin e të dhënave monetare në bazë të kërkesave të ECB-së, si dhe kërkesave të reja të ECA 2010).</p> <p>ST16 Vendosja e veglave për analiza të brendshme të të dhënave statistikore dhe internet portalit statistikor për përdoruesit e jashtëm të të dhënave.</p>
SP	<p>SP1 Përditësimi i aplikacionit bankimi elektronik</p> <p>SP2 Statistikë pagesore për mbikëqyrjen nga jashtë të sistemeve pagesore.</p> <p>SP3 Përditësimi i aplikacionit për dorëzimin e të dhënave të statistikës pagesore.</p> <p>SP4 Dorëzimi dhe përpunimi elektronik i urdhrave për zbatim (e-zbatimi).</p>
MJL	<p>MJL1 Përgatitja e një mostëre për raportet e MJL-së.</p> <p>MJL2 Përgatitja e raporteve për portfolion krahasuese.</p>

	MJL5	Përgatitja e raporteve për krahasim të individëve të cilët kanë kryer transaksione të transferimit të shpejtë të parave.
TR	TR1 TR2	Shtojca në aplikacionin "Thesari". Përpunimi i një moduli të ri "Ekspertizë dhe evidencë e parave të dëmtuara"

NjO	Titulli i IT-projektit
FB	<p data-bbox="300 304 1380 371">FB1 Agregimi i raporteve nga aplikacioni EriKlient për limitet e ekspozimit të bankave.</p> <p data-bbox="300 405 1380 472">FB2 Harmonizimi i modeleve të rasteve të punës për seritë kohore dhe agregimi në aplikacionin EriKlient me ndryshime në rregullativë.</p> <p data-bbox="300 506 1380 573">FB6 Harmonizimi me ndryshimet në rregullativën dhe plotësimi i raportit për kreditë e reja të miratuara.</p>
TF	<p data-bbox="300 633 1380 678">TF1 Raporte BTH (bono të thesarit) dhe LSHV (letrat shtetërore me vlerë)</p> <p data-bbox="300 689 1380 734">TF2 Shpërndarja e rrezikut të interesit</p> <p data-bbox="300 745 1380 779">TF3 Harmonizimi i praktikave më të mira për monitorimin e rreziqeve.</p>
FKK	<p data-bbox="300 790 1380 835">FKK1 Sistem i integruar për kontabilitet</p> <p data-bbox="300 869 1380 913">FKK2 Softuer të ri për planifikim</p> <p data-bbox="300 925 1380 1014">FKK3 Përpunimi i një zgjedhjeje të re aplikative për kalkulimin e pagës dhe tatimit dhe të ardhurave personale.</p> <p data-bbox="300 1048 1380 1093">FKK4 Udhëtime zyrtare dhe regjistrim kontabël.</p>
IT	<p data-bbox="300 1111 1380 1155">IT1 Përshtatja e Qendrës për IT-shërbime</p> <p data-bbox="300 1167 1380 1200">IT2 Konvertimi i një pjese të aplikacioneve Access në .Net</p>
BA	<p data-bbox="300 1211 1380 1256">BA1 Zgjedhje aplikative për arkiv të digjitalizuar historik</p>
MT	<p data-bbox="300 1279 1380 1323">MT1 Aplikim për kryerjen e mbikëqyrjes në terren.</p>

